

Drejtuar: Z. Petrit AHMETI
Kryetar
Enti Rregullator i Energjisë

Lënda: Kërkesë për Miratimin e Tarifës së Transmetimit të Gazit Natyror

I nderuar Z. Ahmeti,

Me Vendimin Nr. 848, datë 07.12.2016, për “Krijimin e Shoqërisë “Albgaz” Sh.A. dhe për Caktimin e Autoritetit Publik që Përfaqëson Shtetin si Pronar të Aksioneve të Shoqërive Albpetrol Sh.A. dhe Albgaz Sh.A.”, Këshilli i Ministrave, ka krijuar autoritetin publik që është përgjegjës për trasmetimin, shpërndarjen dhe depozitimin e gazit natyror ne Republikën e Shqipërisë, e cila është Shoqëria “Albgaz” Sh.A.

Në vijim të kësaj VKM-je, në datë 05.01.2017, aksioneri i vetëm i Shoqërisë “Albgaz” Sh.A., Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ka aprovuar statutin e kësaj Shoqërie dhe ka kryer rregjistrimet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit sipas kërkesave të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

Në zbatim të Udhëzimit Nr.394 Datë 21.08.2014 “Mbi Programet e Zhvillimit Ekonomik të Shoqërive Tregëtare me Kapital Shtetëror”, shoqëria Albgaz Sh.A. ka hartuar Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2018, si dhe për 3 (tre) vjecarin e ardhshëm 2018-2021 në përputhje me objektivat e përcaktuara nga organet drejtuese.

Përcaktimi i çmimit të transmetimit të gazit natyror, për shkak të mungesës së të dhënave historike të këtij sektori është e pamundur të zbatohet në tërësinë e saj draft metodologjia e përcaktuar në Vendimin ERE Nr. 178, Datë 08.11.2017 “*MBI MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFAVE TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR*”. Albgaz sh. a mund të sigurojë të dhënat vetëm për vitin 2017 mbi kostot e rrjetit, si dhe parashikimin e kostove të përgjithshme të shoqërisë për vitet në vijim. Kostot e parashikuara për vitin 2018 mund të jenë me marzhin me të ulët të pasaktësisë, ndërkohe për vitet në vijim ka pasiguri. Gazifikimi i Shqipërisë

është një koncept i ri, dhe parashikimi i kostove është i bazuar në parim tek Plani i Zhvillimit Ekonomik të shoqërisë, por përsëri nuk ka baza historike të cilat do kishin mundësuar të dhëna të sakta të ecurisë dhe një marzh të ulët pasaktësie.

Viti 2017 evidentoi faktin që sektori i gazit në Shqipëri, me infrastrukturë të ngritur që prej vitit 1971 ka nevojë për mirëmbajtje dhe investime të vazhdueshme në mënyrë që të minimizohen humbjet e gazit dhe të kryhet aktiviteti parësor i transmetimit dhe shpërndarjes të gazit natyror. Perspektiva për vitin 2018 është e lidhur me krijimin e marrëveshjeve të reja e të qëndrueshme tregëtare. Krijimi i këtyre marrëveshjeve do të kushtëzojë projektet inxhinierike për të krijuar linja të reja për transmetimin e gazit në drejtim të klientëve.

Shoqëria Albgaz sh.a parashikon rritjen e fondit të mirëmbajtjes, që do të rezultojë në uljen e ndjeshme të shpenzimeve të humbjes së gazit në rrjetin e transmetimit. Sipas bilanceve të transmetimit të gazit nga Drejtoria Teknike humbjet janë të vazhdueshme dhe janë si pasojë e vjetërsisë së linjave. Për këto arsye stafi i Drejtorisë Teknike dhe i Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëveshjeve do të jenë subjekt për trajnime të vazhdueshme mbi teknikat më të fundit për mirëmbajtje dhe operim linjash. Pavarisht investimit që parashikohet të kryhet në drejtim të stafit, kjo nuk është përfshirë në kostot e paraqitura. Për të mbuluar nevojat e shoqërisë për funksionim sipas standarteve moderne tarifa e transmetimit dhe shpërndarjes nuk mund të jete ulët se 40 lekë per Nm³. Kjo tarifë perfaqëson ngushtësisht të ardhurat e kompanise që mund të mbulojnë veprimtarinë në kushtet e investimeve për ngritje kapaciteti.

Referuar Vendimit Nr.90, Datë 07.06.2017 " Mbi Miratimin e Tarifës së Përkohshme të Transmetimit të Gazit Natyror nga Shoqëria "Albgaz Sh. a" për periudhën 05.01.2017-20.09.2017, Enti Rregullatorë i Energjisë vendosi:

- 1. Miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria "ALBGAZ" sh.a prej 25 Leke/m³, për periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017.*
- 2. Përditësimi dhe kompesimi i të gjitha efekteve të mundshme financiare për shoqërinë "ALBGAZ" sh.a për periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017, do të bëhet në periudhën pasardhëse sipas përcaktimeve të nenit 17, pika "e" të Ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e Gazit Natyror"*

Vendimi Nr.155, Datë 28.09.2017 "Mbi lënien në fuqi të Vendimit të Bordit të ERE-s Nr.90, Datë 07.06.2017 "Mbi Miratimin e Tarifës së Përkohshme të Transmetimit të Gazit Natyror nga Shoqëria "Albgaz Sh. a" për periudhën 05.01.2017-20.09.2017, deri në 31.12.2017 Enti Rregullatorë i Energjisë vendosi:



nga Shoqëria "Albgaz Sh. a" për periudhën 05.01.2017-20.09.2017, deri në 31.12.2017 Enti Rregullatorë i Energjisë vendosi:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 90, datë 07.06.2017 "Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria "Albgaz" sh.a. për periudhën 05.01.2017-20.09.2017" deri në 31.12.2017
2. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të ALBGAZ sh.a. përditësimi dhe kompensimi i tyre do të bëhet në periudhën pasardhëse sipas përcaktimeve të nenit 17, pika "e" të Ligjit nr.102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror"

Shoqëria "ALBGAZ" Sh. a po proçedon me faturimin për shërbimet e transmetimit të gazit natyror deri në afatin e përcaktuar në Vendimin nr.90, pika 2, si dhe Vendimin nr.155, pika 1 dhe 2.

Me qëllim vazhdimësinë normale të proçesit të punës në kushtet kur bazuar në vendimin e sipërcituar kjo tarifë e përkohshme është e vlefshme deri me datë 31.12.2017 si dhe nuk kemi një tarifë përfundimtare për transmetimin e Gazit Natyror, kërkojmë nga Juaj miratimin e tarifës prej 40.00 (Dyzetë) lekë/m3 Gaz Natyror.

- Bashkëlidhur kësaj shkrese po Ju dërgojmë:
 - Projek Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin 2018,
 - Analizën e Kostove për Caktimin e Tarifës së Transmetimit,
 - Plan Biznesi për 2018-2020.

Duke ju falenderuar për miqësinë tuaj.

Me respekt,

Genci GJEÇI

Administrator

OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR

ALBGAZ SH.A.



***ANALIZA E KOSTOVE PER CAKTIMIN E TARIFES SE TRANSMETIMIT TE GAZIT NATYROR**

	Emertimi		Kosto Operacionale 2018
1	Kosto Page	000/Leke	45,757
2	Trajtime	000/Leke	3,000
3	Sigurimet shoqerore	000/Leke	7,641
4	Te tjera konstante	000/Leke	200
5	Lubrikant-Karburant	000/Leke	3,500
6	Energji elektrike	000/Leke	9,000
7	Shpenz Marteriale + veshje pune	000/Leke	5,500
8	Shpen.zhdemtim mjedisi- vl mjedisor	000/Leke	1,800
11	Humbje	000/Leke	1,400
	C (Elementet e Kostots sipas Nenit 7)	000/Leke	77,798
	D (Amortizimi sipas percaktimit Neni 8)	000/Leke	11,500
	ROC (Kthimi mbi kapitalin sipas Nenit 9)	000/Leke	55,142
	CRI (Te ardhura te zbritshme sipas Nenit 10)	000/Leke	-
	OPC (Axhustime sipas Nenit 11)	000/Leke	-
	GC = C + D + ROC - CRI + OPC	000/Leke	144,440
	Sasia e Transmetuar (000 / NM3)		3,611
	Tarifa e Transmetimit		40.00

Nr	EMERTIMI	Njesia	Program	Parashikim	Parashikim
			Zhvillimi Ekonomik 2018	Viti 2019	Viti 2020
I	TE ARDHURAT (shp.transporti tras)	000, L	246,540	421,720	640,740
a	Trasmetim Gazi	000, L	144,440	300,000	500,000
b	Me te trete	000, L	10,500	11,800	12,500
c	Te ardhura nga mirembajtja e linjave te te treteve	000, L	91,600	109,920	128,240
III	Rezultati Financiar	000, L	60,556	252,440	272,985
II	SHPENZIME GJITHSEJ (A+B)	000, L	185,984	252,440	272,985
A.	SHPENZIME KONSTANTE (1+2+3+4+5)	000, L	121,952	175,242	188,067
1	Shpenzimet per pagat	000, L	95,800	101,420	111,562
2	Sigurimet shoqerore (16.7%)	000, L	15,999	16,937	18,631
				7,157	7,873
3	Shperblime K. Mbikqyres	000, L	2,052	2,288	2,517
4	Amortizimi	000, L	11,500	41,000	41,000
5	Te tjera konstante	000, L	200	6,440	6,484
	Interesa Kredie			6,000	6,000
	* Ndhma per semundje e fatkeqsi	000, L	200	440	484
B.	SHP. VARIABL (6+7+8+9+10+11)	000, L	64,032	77,198	84,918
6	Shpenzime materiale dhe sherbime	000, L	5,768	9,185	10,104
	*Karburant	000, L	1,600	5,280	5,808
	*Lubrikant	000, L	817	825	908
	*Pjese kembimi per mak-paisje	000, L	2,951	3,600	4,200
	*Te tjera materiale dhe sherbime	000, L	400	1,760	1,936
	*Veshje Pune Terren			1,500	2,000
7	Energjia elektrike	000, L	9,200	10,120	11,132
8	Sherbime nga te trete	000, L	7,000	5,980	6,178
	*Riparime makineri e paisje	000, L	7,000	4,000	4,000
	- Nga Albpetroli	000, L			
	- Nga Private	000, L			
	*Transport	000, L			
	- Nga Private	000, L			
	*Ruajtje objekti	000, L		1,980	2,178
9	*Shpenz.Zhdem,Rregull,Pastr.Mjedisi	000, L	1,000	1,100	1,210
10	Shpenzime Administrative	000, L	39,664	65,903	71,844
	*Dieta Udhetime	000, L	4,000	7,150	7,865
	*Kancelari	000, L	1,400	13,200	14,520
	*Shpenzime te tjera(pritje percjellje/Licencim/Projektim /EKR etj)	000, L	5,200	13,200	14,520
	*Shpenzime bankare	000, L	100	200	250
	* Shpenzime telefoni	000, L	880	968	1,065
	*Shpenzime Gjyqi e noterie	000, L	2,684	2,915	3,207
	*Shpenzime per kualifikim,	000, L	10,500	11,800	12,500
	*Tatim pasurie,taksa,siguracion	000, L	1,200	1,320	1,452
	*Mirembajtje Zyra	000, L	400	400	400
	*Shpenzime Mjekesore	000, L	200	500	700
	*Vleresim Mjedisor	000, L	1,500	1,650	1,815
	*Shpenzime Qera	000, L	8,400	8,600	9,000
	*inventar I Imet	000, L	820	800	800
	*Materiale Promoc dhe Spenz Marketingu	000, L	1,500	1,700	2,000
	*Informatizim	000, L	880	1,500	1,750

11	Humbje (+Gaz+interes.)	000, L	1,400	50	50
*	NUMRI MESATAR PUNONJESVE	Nr.	117	117	117
*	PAGA MESATARE MUJORE	L/P	68,234	72,236	79,460
*	FONDI I PAGAVE	000, L	95,800	101,420	111,562
*	Detyrim Sigurimet shoq.(16.7%)	000, L	15,999	16,937	18,631
*	Tatim Fitimi derdhje ne Buxhet	000, L	9,083	37,866	40,948
*	TVSH derdhje ne buxhet	000, L	42,861	213,817	80,861
A	Investime Gjithesej=(B+C+D)	000, L	141,606	4,083,235	656,609
B	Ndertim-Montime-Tubacione	000, L	17,000	4,050,000	620,000
C	Rikonstrukcion Zyra Fier	000, L	35,565	-	-
D	Ndertim 2 Magazina	000, L	44,672	-	-
E	Makineri e Pajisje (a+b)	000, L	12,000	1,500	1,700
	a)Blerje Mak-Pajsje	000, L	10,000	1,000	1,000
	*Albpetrol & Privatet	000, L			
	*Albpetrol & Privatet	000, L			
	*Albpetrol & Privatet	000, L			
	b)Rem.kapital makineri & pajisje	000, L	2,000	500	700
	*ALB+Privat	000, L			
	*ALB+Privat	000, L			
	Nga privatet	000, L			
D	shuma '1+2+3+4	000, L	32,369	31,735	34,909
1	Mjedisi	000, L	-		-
2	Invest. Ngritje Kapaciteti	000, L	6,075	8,168	8,984
3	Informatizimi	000, L	10,064	6,683	7,351
4	Pajisje dhe Orendi	000, L	14,850	16,335	17,969
5	Te tjera	000, L	1,380	500	500
E	Pajsje zyre (Donacion TAP AG)	000, L			
F	Kompjuter (Donacion TAP AG)	000, L			
G	AAJM	000, L			